



GAZETA SHQIPTARE

E premte - 04 Shtator 2009 | Nr 4534 Viti XV

ONLINE



aa|| Kerko:a

-GazetaSH-

Kërko!

Na Shkruani | Rreth Nesh | Kontakt

|| Faqet e Gazetës

- EDITORIAL
- Faqe2-3
- Faqe4-5
- Faqe6-7
- Faqe8-9
- Faqe10-11
- Faqe12-13
- Faqe14-15
- Faqe16-17
- Faqe18-19
- Faqe20-21
- Faqe22-23
- Faqe24-25
- Faqe26-27
- Faqe28-29
- Faqe30-31
- MILOSAO
- BLUETOOTH
- ELECTIONS IN ENGLISH

|| Bluetooth në PDF



Ndotja, largohen kimikatet në Bajzë

» [Dërguar më: 14/05/2008 - 13:34](#)

Brikena Shllaku

MALESI E MADHE Mbi 250 ton kimikate të rrezikshme që prej 16 vitesh ndodhen të magazinuara në Bajzë të Malësisë së Madhe, do të largohen që andej falë një projekti të PNUD-it dhe qeverisë holandeze. Prezenca e këtyre kimikateve pohohet të jetë një nga problemet më të mëdha të kësaj zone, pasi nga ndotja e madhe e ambientit është shënuar jo vetëm një ngordhje masive e peshqve në Liqenin e Shkodrës dhe të pjesës së këtij liqeni që i përket Malësisë së Madhe, por edhe shtimi i pacientëve me sëmundjen e kancerit. Situata alarmante ka nxitur drejtuesit lokalë, që të kërkojnë heqjen e këtyre lëndëve të rrezikshme, të cilat janë kthyer në një rrezik serioz për jetën e njerëzve. Për largimin e kimikateve që ndodhen në Bajzë, qeveria holandeze ka dhënë një fond prej 2.1 milionë dollarësh. Bashkëfinancues në këtë projekt është dhe qeveria shqiptare, me një fond prej 900 mijë dollarësh. Ky projekt është prezantuar pak ditë më parë në qytetin e Shkodrës nga shoqata mjedisore, ku dhe është konkretizuar premtimi për financimin nga ana e qeverisë holandeze.

KIMIKATET

Viti 2010 do të shënojë pastrimin e zonës së Bajzës nga lëndët kimike tepër të rrezikshme. Drejtues të Komunës së Kastratit (ku përfshihet Bajza) pohojnë se rreth 480 ton kimikate të rrezikshme u sollën në këtë zonë nga Gjermania, nëpërmjet kompanisë "Schmidt-Cretan", në vitin 1992. Sipas specialistëve, sasia e ardhur përmbante lëndë të rrezikshme si: "Toxaphene" dhe "Phenyl Mercury Acetate", të cilat janë ndaluar në vendet e BE-së që nga viti 1983. Që prej asaj kohe, Bajza vazhdon të vuajë pasojat e kësaj ndotjeje. Kryekomunari i Kastratit, Gjovalin Vneshti pohon faktin se deri para disa kohësh, këto lëndë kancerogjene kanë qenë të vendosura në disa magazina të shkatërruara (pa dyer e dritare), thuajse në vend të hapur, duke rrezikuar kryesisht fëmijët që shkonin e luanin aty. Pas alarmit të dhënë nga krerët e qeverisjes vendore, u larguan një pjesë e këtyre lëndëve dhe aktualisht në Bajzë ndodhen 250 ton. Gjithashtu, u morën masa për rregullimin e magazinave, si dhe u vendosen roje pranë këtyre objekteve.

PROJEKTI

Prof.dr.Lirim Selfo, menaxher i projektit për pikat e nxehta mjedisore, thotë se projekti për heqjen e kimikateve të rrezikshme nga Bajza ka filluar në shtator të 2007-ës, si dhe do të përfundojë më mars 2010. "Përzgjedhja e firmës që do të zbatojë projektin, do të bëhet me një tender ndërkombëtar, ku do të kryhet jo vetëm largimi i helmeve, por edhe rehabilitimi i zonës së ndotur, për ta rikthyer atë në një zonë të pastër", - sqaron Selfo. Projekti që po zbatohet nga PNUD-i dhe donacioni holandez, do të kalojë në disa faza. Sipas Lirim Selfos, faza e parë ka pasur si objektiv identifikimin e sasisë për të gjithë zonën; faza e dytë ka të bëjë me ambalazhimin e të gjithë sasisë, për të vazhduar me fazën finale, largimin në destinacionin përfundimtar. Ndërsa ende nuk është caktuar vendi ku do të depozitohen për t'u eliminuar kimikatet e rrezikshme të Bajzës.

Print Email

Kthehu Pas

Faqja e Pare




Sakcinski: Akt pas akti, historitë e trimit Skënderbe

Në njëgind vjetorin e poetit të madh grek Janis Ricos (Në vend të një kartoline urimi)

• Besnik Mustafaj

Jacqueline Susann "Lugina e kukullave", romani sensacional

|| Milosao në PDF



Ndalohet rreptesisht prodhimi i faqes ose nje pjese te saj pa kerkuar nje leje te shkruar.
Copyright 2007 Gazeta Shqiptare
Perdorimi i lajmeve mund te behet duke permendur burimin, nese jo kjo eshte nje shkelje e te drejtave.